

## **”Efikasiteti i herbicideve të kombinuara për kontrollin e barojave pas mbirjes së misrit ”**

### Abstrakti

Hulumtimet për efikasitetin e herbicideve të kombinuara për kontrollin e barojave pas mbirjes së misrit janë kryer në fshatin Vragoli, komuna e Fushë Kosovës. Misri është mbjell në afatin optimal në vitin 2021. Vendosja e eksperimentit është bërë sipas blloqeve të randomizuar me nga katër përsëritje. Në eksperiment kanë qenë gjashtë tretmane: katër tretmane me përdorim të herbicideve të kombinuara dhe me doza të ndryshme, një me intervenim mekanik dhe një ngastër kontroll pa përdorim të herbicideve dhe pa intervenim mekanik. Ngastrat kanë pasur madhësinë prej 10 m<sup>2</sup>. Kombinimet e herbicideve që janë përdorur: nikosulfuron + dikamba, nikosulfuron + 2,4-D, nikosulfuron + 2,4-D-etilheksilester, nikosulfuron + florasulam + 2,4-D-2-etilheksilester. Barojat dominante ishin: *Cirsium arvense* (gjemb i arave) dhe *Hibiscus trionum* (banja e qeve). Nga 14 lloje të barojave të regjistruara në misër, gjethgjëra ishin 78.6% dhe gjethengushta 21.4%, kurse sa i përket ciklit biologjik 71.0% ishin njëvjeçare dhe numri i llojeve shumëvjeçare ishte 29.0%. Efikasitetin më të lartë e ka arritur kombinimi i herbicideve nikosulfuron + dikamba 87.4% dhe nikosulfuron + florasulam + 2,4-D-2-etilheksilester 86.3%. Të gjitha kombinimet e herbicideve kanë ndikuar në rendimentin e misrit, rendimenti më i lartë është arritur në ngastrat ku është përdorur kombinimi i herbicideve nikosulfuron + dikamba 6.4 t/ha dhe nikosulfuron + florasulam + 2,4-D-2-etilheksilester 6.3 t/ha.

Fjalet kyçe: misri, barojat, herbicidet, efikasiteti